



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Hyrje në Gjuhësi

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 30 leksione / 10 seminare
Viti / Semestri : Viti I , semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*
Kodi i etikës: Kodi i etikës i Ut-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme të lëndës: Studenti duhet të jetë i aftë të njohë konceptet bazë që ngërthejnë disa disiplina gjuhësore si: fonetika, morfologjia, sintaksa, leksikologjia, semantika, semiotika; njohë nocionet dikotomike dhe karakteristikat e brendshme të gjuhës; interpretojë leksionet dhe materialet që ofrohen në mënyrë të pavarur.

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet të jetë i aftë të:

1. Të asimilojë konceptet kryesore të shkollave të ndryshme gjuhësore mbi gjuhën dhe ligjërimin.
2. Të përthithë konceptin e kodit gjuhësor dhe të komunikimit midis njerëzve.
3. Të asimilojë karakteristikat dhe dallimet midis ligjërimit të njerëve, kafshëve dhe atij jo verbal.
4. Të njohë dhe asimilojë klasifikimin e gjuhëve të botës dhe në veçanti të gjuhës italiane dhe asaj shqipe.